



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 290/1 Prot.

Tiranë, më 21 / 02 / 2019

V E N D I M

Nr. 26 , Datë 21 / 02 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 150, datë 19.09.2018, të paraqitur nga Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër, kundër Bashkisë Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: *“Që prej datës 24.07.2018 shoqata e invalidëve para dhe tetraplegjikë, dega Shkodër i është drejtuar Bashkisë Shkodër me disa kërkesa lidhur me përshtatjen e një tualeti ekzistues që ndodhet pranë zyrës së shoqatës, por që nuk ka marrë përgjigje për zgjidhjen e këtij problemi. Problematikë tjetër për personat me aftësi të kufizuar është dhe parkimi publik, si një e drejtë ligjore që iu njihet personave me aftësi të kufizuar, i cili nuk është i aksesueshëm për këto persona, pasi hapësirat e parkingut të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar përdoren çdo ditë edhe nga persona të tjerë dhe Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë masë në lidhje me këtë problem. Gjithashtu, në Bashkinë Shkodër ekziston një rampë e cila nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar, pasi çdo ditë bllokohet nga automjetet të cilat parkojnë aty dhe është e pamundur që personat me aftësi të kufizuara të përdorin rampën¹”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e problemeve të ngritura.

¹ Blllokimi i kalimit të rampës është konstatuar dhe nga zyra rajonale e KMD-s, Shkodër si dhe është shoqëruar me foto.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1300/1, datë 21.09.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Shkodër për ankesën e bërë nga Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër.

Me shkresën nr. 16251, datë 03.10.2018, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Shkodër në mes të tjerash informoi se: “Bashkia Shkodër në vitin 2017 ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, me nr.11054, datë 17.07.2017 dhe me vlefshmëri deri në datë 01.08.2018. Bashkia e Shkodrës ka siguruar ambjente dhe bashkëpunon me këtë shoqatë për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi ndryshe. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

rinovuar dhe për vitin 2018, me nr. 13386, datë 15.08.2018 për afat një vjeçar me të drejtë rinovimi, me synim vazhdimin e bashkëpunimit. Në kuadër të bashkëpunimit dhe kërkesës së paraqitur nga shoqata për përshtatjen e një tualeti për personat me aftësi ndryshe, Bashkia e Shkodrës, ka marrë masat dhe ka projektuar ndërhyrjet infrastrukturore të nevojshme për krijimin e tualetit. Aktualisht po vlerësohen mundësitë për sigurimin e financimit të nevojshëm për përshtatshmërinë e tualetit. Përsa i përket çështjes së parkimit publik, në vitin 2017, Bashkia e Shkodrës për herë të parë ka krijuar hapësirat e parkimit për personat me aftësi ndryshe. Policia Bashkiake në vazhdimësi ka marrë masa ndaj subjekteve që shkelin rregullat e qarkullimit rrugor (ku hyn edhe parkimi) për të cilën, në zbatim të Kodit Rrugor merr masa edhe Policia e Shtetit, specifikisht për parkimin e rezervuar për personat me aftësi ndryshe. Ndërsa përsa i përket problemit të bllokimit të rampës në Bashkinë e Shkodrës, e cila bllokohet nga automjetet që parkojnë para saj, ju informojmë se aksesit është krijuar në vazhdimësi dhe do të merren masa të shtuara për monitorimin dhe sigurimin e lëvizjes së lirë”.

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Shkodër, Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër, me shkresën nr.25, datë 22.10.2018 në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Bashkia Shkodër ka projektuar ndërhyrjet infrastrukturore të nevojshme për krijimin e tualetit, por nuk ka përcaktuar një afat kohor të qartë për vazhdimin e punimeve. Si rezultat i kësaj, shoqata nuk ka një informacion të saktë. Bashkia Shkodër ka krijuar hapësirat e parkimit për personat me aftësi ndryshe, por ka një mungesë të plotë në ristampimin e logove që përcaktojnë hapësirat ku mund të parkojnë personat me aftësi ndryshe. Ndërsa përsa i përket çështjes së bllokimit të rampës në Bashkinë Shkodër, nuk ka një masë konkrete të shtuar për monitorimin dhe sigurimin e hapësirës së duhur për aksesueshmëri”.*

- Me shkresën nr. 1300/3, datë 05.11.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga Bashkia Shkodër shpjegime shtesë lidhur me:
 - Informacion mbi afatin kohor se kur do të fillojnë dhe mbarojnë punimet lidhur me krijimin e tualetit pranë Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, si dhe kopje të projektit të planifikuar.
 - Informacion të detajuar mbi masat e marra nga Policia Bashkiake Shkodër kundër subjekteve që kanë shkelur rregullat e qarkullimit rrugor duke zënë hapësirat e planifikuara për personat me aftësi të kufizuara nga periudha 01.01.2018 deri më sot.
 - Informacion mbi planifikimin e Bashkisë Shkodër për ristampimin e logove të hapësirave të planifikuara për personat me aftësi të kufizuara, për vitin 2018. Nga ana e Bashkisë Shkodër nuk ka pasur një përgjigje mbi kërkesën e bërë.
- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1300/4, datë 26.11.2018 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 05.12.2018 duke kërkuar shpjegime nga Bashkia Shkodër për çështjen në fjalë.

Seanca u zhvillua në mungesë të subjektit ankues dhe me praninë e J.Xh si përfaqësuese e Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Shkodër dhe të A.H me detyrë K/Inspektor i Policisë Bashkiake Shkodër.

Përfaqësuesja e Bashkisë Shkodër, dorëzoi shkresën nr.20136, datë 05.12.2018 në të cilën informohet Komisioneri se: *“Në kuadër të bashkëpunimit dhe kërkesës së paraqitur nga shoqata për përshtatjen e tualetit për personat me aftësi ndryshe, Bashkia e Shkodrës ka marrë masat duke projektuar ndërhyrjet infrastrukturore të nevojshme për krijimin e tualetit dhe me mbështetjen e organizatave partnere (Shoqata “Shpresë për Jetën”) në muajin nëntor janë realizuar punimet për përshtatjen e tualetit për personat PAK, e cila do të shërbejë për Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë dhe shkollën pranë së cilës ndodhen zyrat e shoqatës. Gjatë vitit 2018, Policia Bashkiake ka vendosur rreth 180 gjoba për subjektet që kanë shkelur rregullat e qarkullimit rrugor dhe kanë zënë hapësirat e dedikuara për personat me aftësi ndryshe. Bashkia Shkodër ka krijuar rreth 20 hapësira për parkimin e personave PAK. Në buxhetin e vitit 2019 është parashikuar ristampimi i logove pranë hapësirave ekzistuese dhe shtimi i hapësirave të reja. Aksesit për lëvizjen e lirë të personave PAK në hapësirën e rampës pranë Bashkisë Shkodër është realizuar dhe monitorohet në vazhdimësi nga Policia Bashkiake”.*

Në vijim të plotësimit me dokumentacion për detyrat e lëna gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Bashkia Shkodër me e-mail-et datë 11 dhe 12.12.2018 ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacion lidhur me planifikimin e hapësirave të parkimit për personat PAK, buxhetin e planifikuar nga bashkia në lidhje me sinjalistikën rrugore, dokumentacionin teknik mbi përshtatjen e tualetit të shkollës “Ali Laçej” për personat me aftësi të kufizuar si dhe planizimin e shërbimit ditor me detyrat e ngarkuara për shërbimin e Policisë Bashkiake të datës 03.10.2018 në të cilin një nga detyrat e ngarkuara është dhe monitorimi dhe marrja e masave administrative për zënie e vendqëndrimeve të personave me aftësi ndryshe.

Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër, me e-mail-in datë 19.02.2019, ka informuar Komisionerin se është plotësuar problematika e ngritur nga ana e tyre në drejtim të gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë Shkodër lidhur me përshtatjen dhe funksionimin e tualetit pranë mjediseve të shoqatës si dhe është marrë reagimi i duhur nga ana e bashkisë për restaurimin e rampës dhe ristampimin e logove të vendparkimeve të personave me aftësi të kufizuar.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon dhe vlerëson, se kërkesa e Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër, është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të përshtatjes dhe aksesueshmërisë të problematikave të ngritura nga personat me aftësi të kufizuara të qytetit të Shkodrës dhe inkurajon Policinë Bashkiake Shkodër që në vijimësi të garantojë shfrytëzimin e hapësirave të parkimit të parashikuara për personat me aftësi të kufizuar dhe të sigurojë mosbllokimin e rampës në mjediset e bashkisë.

Komisioneri sjell në vëmendje të Bashkisë Shkodër, që të vazhdojë punën në drejtim të sigurimit që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të vazhdojë zbatimin e standarteve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Shkodër, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008 Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 150, datë 19.09.2018, të bërë nga Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër kundër Bashkisë Shkodër, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA